**LIGJ**
**Nr.8339, datë 30.4.1998**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE**

Në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Agjencia e Trajtimit të Kredive, që më tej do të quhet "Agjencia", krijohet në bazë të këtij ligji dhe synon zgjidhjen e problemit të shlyerjes së kredive të dhëna nga bankat tregtare me kapital tërësisht shtetëror deri në datën 31.12.1997.

Kjo Agjenci krijohet për të bërë të mundur shlyerjen me një kosto sa më të ulët të kredive pranë bankave me kapital tërësisht shtetëror.

Ajo nuk ka për objekt të veprimtarisë së saj dhënien e financimeve subjekteve të ndryshme ose bankave.

Neni 2

Agjencia është person juridik shtetëror me seli në Tiranë dhe e ushtron veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo e ushtron veprimtarinë në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera normative në fuqi. Afati normal i veprimtarisë së saj është 3 vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së Agjencisë është:

a) Veprimi si agjente në emër dhe për llogari të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore për të bërë të mundur shlyerjen e kredive të dhëna nga bankat tregtare me kapital tërësisht shtetëror, kredi të cilat do të identifikohen sipas marrëveshjes së veçantë ndërmjet Agjencisë dhe secilës bankë. Për realizimin e kësaj veprimtarie Agjencia, kur vepron si agjente, nuk u lëshon bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror ndonjë garanci për rikthimin e kredive.

b) Të marrë në bilancin e saj të gjitha aktivet e mbetura të Bankës Tregtare Agrare, për të bërë të mundur krijimin e pasiveve në rrugën dhe formën që ajo do t'i gjykojë të përshtatshme dhe të veprojë në emër e për llogari të saj në gjithë veprimtarinë.

Neni 4

Agjencia merr përsipër të zgjidhë problemin e rikthimit të kredive vetëm kur nga bankat shtetërore janë kryer të gjitha veprimet e kërkuara për shlyerjen e kredive pranë tyre.

Agjencia nuk do të pranojë të marrë përsipër shlyerjen e kredive të bankave tregtare me kapital shtetëror, për të bërë të mundur rikthimin e tyre, pa një marrëveshje paraprake me bankën, e cila i ka dhënë këto kredi.

Marrëveshja e parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni do të bëhet në përputhje me rregullat e Bankës së Shqipërisë lidhur me klasifikimin e kredive.

Neni 5

Agjencia, për të bërë të mundur shlyerjen e kredive, ka të drejtë të kryejë veprimet ligjore për përmbushjen e detyrimeve të njohura nga Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile, si dhe të kërkojë pranë organeve të njohura nga ligji fillimin e procedurave të falimentimit e të likuidimit ndaj personave të nuk kanë shlyer kreditë pranë bankave tregtare me kapital shtetëror dhe që janë marrë përsipër nga ajo për t'i zgjidhur, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 6

Për të bërë të mundur realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Agjencia ka të drejtë, nëse ajo e shikon të mundur, të bëjë ristrukturimin e kredisë, duke mbajtur parasysh garancitë e vendosura nga personat dhe mundësitë e shlyerjes së kredisë pas këtij ristrukturimi.

Agjencia vetë ose personat e autorizuar prej saj, për realizimin e funksioneve të agjencisë, kanë të drejtë t'u kërkojnë organeve të njohura nga ligji të dhëna pronësie mbi sendet e paluajtshme të debitorëve, jo vetëm për ato që janë hipotekuar si garanci për shlyerjen e detyrimit, por mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme.

Neni 7

Në rast se Agjencia, për përmbushjen e funksioneve të saj, ka kërkuar, kundrejt personave të cilët nuk kanë shlyer kredinë, fillimin e procedurave të falimentimit a likuidimit, ajo nuk ka të drejtë, me cilësinë e kreditorit për shkak të këtyre procedurave, të kërkojë veto ose të miratojë ndonjë plan për riorganizimin e veprimtarisë së debitorit të kërkuar nga kreditorët e tjerë.

Neni 8

Në rastin e kalimit të detyrimeve që rrjedhin nga kreditë e dhëna nga bankat tregtare me kapital shtetëror, për kohën që ato do të trajtohen nga Agjencia, debitorët e bankës kalojnë si debitorë të Agjencisë dhe të gjitha marrëdhëniet për përmbushjen e detyrimeve do të jenë me Agjencinë. Në këtë rast banka, kredia e së cilës do të trajtohet nga Agjencia, dhe vetë kjo e fundit, do të kryejnë të gjitha veprimet ligjore të parashikuara në nenet 499-507 të Kodit Civil për zëvendësimin e kreditorëve.

Agjencia, për të gjitha kreditë që janë parashikuar në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji, ka të gjitha të drejtat e kreditorit, duke përfshirë ndryshimet në marrëveshjen e detyrimit me debitorin për zgjatjen e afatit të shlyerjes së kredisë, të drejtën për të shkëmbyer pjesë të detyrimit të kredive a të interesave, me pjesë të kapitalit a përqindje aksionesh nga shoqëritë kredimarrëse dhe të kërkojë ndjekjen gjyqësore kundrejt debitorëve për përmbushjen e detyrimit.

Neni 9

Agjencia ka të drejtë, pas marrjes përsipër të trajtimit të kredisë me qëllim rikthimin e saj, të pranojë zëvendësimin e debitorit, në përputhje me nenet 496-498 të Kodit Civil, në rast se një zëvendësim i tillë është në interes të shlyerjes së kredisë.

Nëse Agjencia ka pranuar zëvendësimin e debitorit sipas parashikimit të paragrafit të parë të këtij neni, ajo ka të drejtë të bëjë marrëveshjen me këtë të fundit për ristrukturimin financiar të kredisë, si dhe të kërkojë nga debitori i ri vendosjen e garancive të reja për shlyerjen e kredisë, vetëm kur garancitë e dhëna nga debitori i parë nuk kanë qenë të barasvlefshme për shlyerjen e detyrimit.

Në çdo rast, kur është pranuar zëvendësimi i debitorit, sendet e vendosura si garanci ose garancitë e tjera të dhëna nga debitori i parë, mbeten në favor të Agjencisë për shlyerjen e kredisë.

Neni 10

Bankat, kreditë e të cilave do të kalojnë për t'u zgjidhur nga Agjencia, duhet të kalojnë në dispozicion të Agjencisë gjithë dokumentacionin e kredisë dhe kryesisht duhet të kalojnë në favor të saj periudhën e trajtimit të kredisë dhe mjetet që debitori i ka vendosur si garanci për përmbushjen e detyrimit.

Neni 11

Nëse brenda periudhës kohore, gjatë të cilës Agjencia ushtron funksionet e saj, kanë mbetur ende kredi të pashlyera, ato i kalojnë me procesverbal të rregullt bankës që e ka dhënë kredinë, veç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe, me përjashtim të atyre kredive që ajo ka marrë në bazë të shkronjës "b" të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 12

Agjencia, gjatë punës së saj, bën publikimin e debitorëve të vonuar, pavarësisht nga masa e detyrimit të tyre ndaj bankave. Këtë publikim ajo është e detyruar t'ia vërë në dispozicion çdo personi të interesuar.

Neni 13

Organet drejtuese të agjencisë janë:
a) këshilli mbikëqyrës,
b) drejtori i përgjithshëm.

Neni 14

Këshilli Mbikëqyrës i Agiencisë përbëhet nga shtatë anëtarë dhe ka në përbërjen e tij drejtorin e përgjithshëm, katër anëtarë të emëruar nga Ministri i Financave dhe dy anëtarë të emëruar nga Banka e Shqipërisë. Ata janë të emëruar për një periuëhë 3-vjeçare.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë të punësuar të Agjencisë, me përjashtim të drejtorit të përgjithshëm.

Pranë Këshillit Mbikëqyrës funksionon sekretaria e tij, e cila përbëhet nga dy persona dhe mban korrespondencën, procesverbalet e mbledhjeve, përgatit aktet e Këshillit dhe i shpërndan ato. Anëtarët e sekretarisë caktohen nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 15

Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët zgjidhen nga vetë anëtarët e këtij Këshilli. Në këto funksione nuk mund të zgjidhet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë.

Neni 16

Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë personat që kanë një nga kufizimet e mëposhtme:

a) janë në proces gjyqësor ose janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për paaftësi paguese ose falimentim;

b) kanë pengesa ligjore për të qenë nëpunës civilë, sipas nenit 8 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë";

c) më parë kanë abuzuar me pozitën e tyre zyrtare ose me pozitën si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë;

ç) kur është aksionar, anëtar i organeve drejtuese ose punonjës i ndonjë banke të nivelit të dytë;

d) kur është kreditor i ndonjë prej bankave ose aksioner, anëtar i organeve drejtuese, nëpunës ose kreditor i ndonjë debitori ndaj bankave;

dh) kur ligji organik i vendit të punës e përjashton një anëtarësi të tillë;

e) kur personi është në pamundësi mendore për të mbuluar funksionet e ngarkuara.

Neni 17

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës, si rregull, zhvillohet në vendin ku e ka selinë Agjencia. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohen të paktën një herë në tre muaj ose kur një gjë e tillë kërkohet nga kryetari apo të paktën nga tre anëtarë të tjerë të këtij këshilli.

Neni 18

Mbledhjet e Këshillit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit të emëruar në çastin e zhvillimit të mbledhjes.

Vendimet e Këshillit janë të vlefshme kur për to kanë votuar më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve.

Neni 19

Mbledhjet e Këshillit drejtohen nga kryetari dhe, në mungesë të tij apo kur ky është liruar e ka dhënë dorëheqjen nga ky post, ato drejtohen nga zëvendëskryetari i tij. Në rast se edhe zëvenëëskryetari mungon apo është liruar nga detyra a ka dhënë dorëheqjen, ato drejtohen nga një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, i cili zgjidhet ndër anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Anëtari i zgjedhur për drejtimin e mbledhjes me cilësinë e kryetarit e ushtron këtë funksion vetëm për atë mbledhje.

Neni 20

Nëse ndonjë anëtar i Këshillit apo ndonjë person i familjes së tij ka një interes drejtpërdrejtë a të tërthortë për një çështje të caktuar që merret në shqyrtim nga Këshilli, ai duhet të njoftojë më parë për këtë kryetarin ose drejtuesin e mbledhjes, të zgjedhur sipas parashikimit të nenit 19 të këtij ligji, dhe ai nuk duhet të marrë pjesë në mbledhje gjatë kohës që Këshilli e shqyrton këtë çështje.

Në rastin e moszbatimit të parashikimeve të paragrafit të parë të këtij neni nga anëtarët e Këshillit, kur një gjë e tillë konstatohet, ata mbajnë përgjegjësi vetjake për dëmet që i kanë sjellë Agjencisë dhe njëkohësisht largohen menjëherë nga ky Këshill.

Vendimi i largimit merret nga organi që ka bërë emërimin.

Neni 21

Këshilli Mbikëqyrës, në ushtrimin e detyrave të tij, ka këto kompetenca:

1. Miraton kreditë e bankave që do të merren për t'u zgjidhur nga Agjencia sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Përcakton kushtet e marrëveshjes të do të lidhet me bankat tregtare me kapital shtetëror për marrjen përsipër të detyrimit për zgjidhjen e çështjes së shlyerjes së kredive, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë për klasifikimin e kredive.

3. Miraton kushtet e përgjithshme të marrjes në punë dhe i propozon Ministrit të Financave strukturën dhe numrin e personelit të Agjencisë.

4. Ushtron vetë kontrolle mbi punën e kryer nga Agjencia për zgjidhjen e rikthimit të kredive.

5. Kërkon nga drejtori i përgjithshëm raporte lidhur me ecurinë e zgjidhjes së problemit të kredive.

6. Përcakton kushtet dhe termat e pagesave që bankat do të kalojnë në favor të Agjencisë për zgjidhjen e çështjes së rikthimit të kredive.

7. Autorizon drejtorin e përgjithshëm, sa herë që kërkohet nga ky i fundit, për të angazhuar në trajtimin e problemeve të nëryshme persona jashtë Agjencisë, të cilëtjanë ekspertë të fushave të caktuara, si dhe miraton shpërblimet dhe kontratat-tip që drejtoria do të lidhë me këta persona.

8. Harton rregulloren e punës dhe procedurat për zhvillimin e mbledhjeve.

9. Shqyrton bilancin vjetor dhe përfundimtar të Agjencisë dhe ia paraqet për miratim Ministrit të Financave.

Neni 22

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë është shtetas shqiptar dhe emërohet nga Ministri i Financave për një periudhë 3-vjeçare. Ai duhet të plotësojë të gjitha kriteret e parashikuara në këtë ligj për antarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Drejtori i përgjithshëm mund të vazhdojë të qëndrojë në detyrë edhe pas afatit të paragrafin e parë të këtij neni për tre vjet të tjera me miratimin e Ministrit të Financave vetëm në rast se afati i veprimtarisë së Agjencisë zgjatet me ligj me shumë se tre vjet.

Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të lirohet nga detyra para mbarimit të afatit të parashikuar në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur gjatë ushtrimit të detyrës ndodh ndonjë nga kushtet e nenit 16, kur jep dorëheqjen, kur ai ka kryer një shkelje të rëndë në detyrë ose kur bëhet i paaftë për të përmbushur detyrën e tij për arsye shëndetësore a për arsye të tjera. Të drejtën për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm e ka Ministri i Financave, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 23

Drejtori i përgjithshëm drejton veprimtarinë e përditshme të Agjencisë dhe është person që ka të drejtën e përfaqësimit të Agjencisë në marrëdhëniet me të tretët.

Drejtori i përgjithshëm duhet t'i paraqesë për miratim Këshillit Mbikëqyrës këto dokumente:

1. Strategjinë dhe procedurat që do të përdoren për të arritur qëllimin e përmbushjes së funksioneve të Agjencisë.
2. Buxhetin e nevojshëm që do t'i nevoitet Agjencisë për ushtrimin e veprimtarisë së saj.
3. Masat që do të marrë për kryerjen e veprimeve ligjore lidhur me rikthimin e kredive.
4. Listën e aseteve që do të eliminohen dhe metodat për rikuperimin e tyre.
5. Programet e nevojshme dhe strategjinë e marketingun e Agjencisë.

Neni 24

Fondi i themelimit të Agjencisë është 10 milionë lekë. Ai mund të jetë në lekë dhe në natyrë. Brenda tij përfshihen edhe aktivet dhe pasivet e transformuara sipas nenit 3 të këtij ligji. Mënyra e pagimit të tij dhe modalitetet e përbërjes së tij caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Fondi i themelimit të Agjencisë, si person juridik shtetëror, është në pronësi të shtetit dhe përfaqësohet nga Ministri i Financave.

Neni 26

Viti financiar i Agjencisë fillon më 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor.

Neni 27

Agjencia nuk ka të drejtë të marrë financime në formë kredish ose dhurimesh nga bankat e tjera me seli në Republikën e Shqipërisë a jashtë saj, me përjashtim të rasteve kur një e tillë miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Agjencia mund të marrë fonde në formë kredish a dhurimesh nga institucionet ndërkombëtare financiare, nga organizata të tjera ndërkombëtare ose shtete të huaja nëpërputhje me rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 28

Agjencia merr në favor të saj shumat, të cilat sipas këtij ligji i kalojnë asaj për ato kredi që ajo ka arritur t'i bëjë të shlyeshme. Agjencia ka të drejtë t'u japë shpërblime personave që kanë bërë të mundur shlyerjen e kredisë, në përqindje me shumën e kredisë, e cila në çdo rast nuk duhet të jetë më shumë se 20 për qind e vlerës së kredisë.

Kriteret për dhënien e shpërblimit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe miratohen nga

Ministri i Financave.

Neni 29

Paga e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë dhe e personelit të saj caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shpërblimi mujor i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë caktohet nga Ministri i Financave dhe nuk duhet të jetë mesatarisht më i lartë se 25 për qind e pagës mujore të drejtorit të përgjithshëm. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e përfitojnë shpërblimin sipas këtij neni në varësi me pjesëmarrjen në mbledhje.

Neni 30

Bilanci dhe llogaritë e Agjencisë kontrollohen nga një ekspert kontabël i autorizuar, i cili caktohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 31

Agjencia e mbyll veprimtarinë e saj me ligj. Të drejtën e propozimit për mbylljen e saj e ka Këshilli i Ministrave në bazë të raportit të ministrit të Financave për këtë qëllim. Pasuria e Agjencisë, me përjashtim të kredive të pashlyera, kalon në pronësi të shtetit dhe mënyra e sistemimit të saj do të jetë me aktin e mbylljes së Agjencisë.

Kreditë që kanë arritur të shlyhen pas kryerjes së veprimeve të Agjencisë dhe që rezultojnë të tilla në çastin e mbylljes së saj, u kthehen bankave tregtare me kapital shtetëror, në përputhje me transferimin fillestar të tyre, me përjashtim të atyre që Agjencia i ka marrë në bazë të shkronjës "b" të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 32

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet normative në zbatim të këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi në datën e dekretimit nga Presidenti.

**Shpallur me dekretin nr.2085, datë 12.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**